

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Calzaturificio Giada” SHPK

Ortakët themelues si më poshtë:

- **Z. Adelmo Ivo Biscuola**, shtetas italian, i datëlindjes 06.12.1954, lindur në Villanova, Roma dhe banues në Jud. Timis, Ors. Buzias, Romania, 6 Martie Nr. 4, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës Nr. YB7674751.
- **Z. Fanio Cauduro**, shtetas italian, i datëlindjes 10.09.1958, lindur në Volpago del Montello, Treviso dhe banues në Volpago del Montello (Treviso) **Italia** in Via F.lli Guardi Nr. 2, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës Nr. YB6494066.

bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, sot më datë 02.03.2022, hartojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

NENI 1
Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “**Calzaturificio Giada**”. Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2
Forma

Shoqëria tregtare “**Calzaturificio Giada**”, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3
Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**Calzaturificio Giada**” SHPK, do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Fier Ballsh BALLSH Rruga Ballsh-Aranitas, Zona Kadastrale 3192, Nr Pasurie 83/5

3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4
Objekti i Veprimtarisë

Objekt i veprimtarisë së shoqërisë është:

Import-eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë të artikujve industrial, lëkur, tekstile dhe prodhime të tyre. Prodhim dhe tregtim me shumicë e pakicë, këpucësh, faqe këpucësh, për llogari të vet dhe për të tretë. Tregtimi dhe përpunimi i veshjeve dhe rrobave të punës, për vete dhe për të tretë (fasoneri), si dhe blerje - shitje të makinerive të përpunimit e prodhimit të lëkurës, pëlhurës dhe të tekstileve. Transport brenda vendit dhe ndërkombëtar për vete dhe të tretë.

Prerje, qepje e prodhim të këpucëve, çantave, rrypave apo veshjeve të lëkurës. Tregëti me shumicë dhe me pakicë edhe on-line prodhimin, importimin dhe eksportimin, shpërndarjen me dhe/ose pa magazinë si kombëtare dhe ndërkombëtare, edhe me marrjen e mandateve të perfaqësimit me dhe/ose pa magazinë, të artikujve ushqimorë, të veshmbathjeve të çfarëdo lloj përbërje dhe vlere, përfshirë bluze dhe këmisheri të jashtëme, aksesore për veshje të çfarëdo lloj materiali, këpucë, veshmbathje lëkure, copa të çfarëdo lloj materiali, fije dhe aksesore rrobaqepësie, paisje dhe artikuj sportive, parfume, kosmetike, bizhuteri, artikuj për dhurata, kancelari, produkte tekstile të çfarëdo lloji dhe materiali përfshirë ato të ardhurave të shitëpive dhe për kujdesin e higjienën personale apo të kafshëve.

Shoqëria mundet gjithashtu të përftojë dhe marrë shpërndarjen me franchising, pra të ketë të drejtë të shpërndajë markat e saj eventuale dhe dijen dhe eksperiencën e saj (knoë-hoë) në franchising, të bëjë çfarëdo lloj aktiviteti të përshtatshëm dhe të lidhur me çfarë është përmendur me lart brenda limiteve ligjore. Mundet të blejë ose marrë me qera dhe mund të marrë përsipër në mënyrë direkte ose indirekte interesat dhe pjesmarrjet në shoqëri të tjera me objekt të ngjashëm

NENI 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

NENI 6
Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria tregtare "Calzaturificio Giada" SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7
Përgjegjësia e Ortakëve

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë "Calzaturificio Giada" SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara prej tyre.

NENI 8
Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Calzaturificio Giada" SHPK është 10.000 (dhjetëmijë) lekë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga të gjithë ortakët.

8.2 Ortakët kanë kontribuar në krijimin e kapitalit të shoqërisë dhe zotërojnë kuotat e tyre në këtë mënyrë:

- **Z. Adelmo Ivo Biscuola**, zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit me vlerë 5,000 lekë, e cila përfaqëson një pjesëmarrje prej 50 % (dhjetë për qind) në kapitalin e shoqërisë;
- **Z. Fanio Cauduro**, zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit me vlerë 5,000 lekë, e cila përfaqëson një pjesëmarrje prej 50 % (tridhjetepesë për qind) në kapitalin e shoqërisë;

NENI 9
Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:



- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10
Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administratori i Shoqërisë është **Z. Adelmo Ivo Biscuola**

NENI 11
Sekretari tregtar



2

Ortakët, administratori dhe punëmarrësit e shoqërisë “Calzaturificio Giada” SHPK përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.


NENI 12

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t’i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Akt Themelimi përpilohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe italiane.

ORTAKËT THEMELUES

Z. Adelmo Ivo Biscuola



Z. Fani Cauduro

